



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.253/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e Koalicionit LDK-AKR dega në Istog, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Istog, për shkak të vendosjes së posterave mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datën 13.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Koalicionit LDK-AKR dega në Istog, dhe Koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Istog, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,300.00 (*tremijë e treqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.06.2017, përmes dërgesës postare, ndërsa sipas datës 12.06.2017 e protokolluar me nr.253/2017, me të cilën pretendon se me datën 08.06.2017, në rrugën “Rinia” në shkollën e mesme “Haxhi Zeka”, tani Qendër e Votimit QV nr. 0601c kemi vërejtur se aktivist të Koalicionit PDK-AAK-NISMA përball shkollës e kanë vendosur mbi rrugë posterin e kandidatit për deputet të Kuvendit të Kosovës . Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur pesë fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Koalicioni LDK-AKR dega në Istog, me datën 13.06.2017, ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës Anr.253/2017, të parashtruar kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Istog.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

PZAP-i, vlerëson nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, rezulton se posterat e kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë vendosur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), i LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e vlerësuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33, pika b), i LZP-së, pasi që posterat e kandidatit Bekë Berisha nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, për deputet të Kuvendit të Kosovës, janë vendosur mbi rrugë publike dhe në vende të ndryshme, pra në rrugën “Skënderbeu”, drejtim i rrugës ( Gurakoc – Istog), rrugën “Fehmi Agani” drejtim i rrugës (Istog i poshtëm – Istog), rruga “Rinia” afër Shkollës së Mesme “Haxhi Zeka” në rrethojën e shkollës nga ana e djathtë në Istog

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase Koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga Koalicioni në fjalë, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, janë vendosur mbi rrugë publike.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni LDK-AKR, i dates 13.06.2017 përmes dërgesës postare dhe protokolluar sipas dates 12.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.253/2017 i datës 12.06.2017, e paraqitur ndaj Koalicionit PDK-AAK-NISMA, PZAP-i vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në mbështetje të nenit 54 par.1 i Ligjit për Procedurën Administratave është parashikuar që “*Tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim*”. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i Koalicionit PDK-AAK-

NISMA, ka cenuar interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) i LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 253/2017 i datës 13.06.2017



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.